



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 433/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4350 (katërmijetreqindpesdhjet) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Më datë 11.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën pretendohet se anëtarët e subjektit politik LDK më datë 10.12.2010 në orën 16:40 në rrugën “Deshmoret e Kombit” në Ferizaj, gjatë fushatës zgjedhore kanë vënë posterat e tyre mbi posterat e PDK, që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi, në të cilën shihen qartë se posterat e kandidatëve për Kuvend të Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-ës, janë vendosur mbi posterat e kandidatit nga radhët e PDK-ës. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

**Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi LDK-ën, më datë 12.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 13.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë nga LDK, sipas afatit të caktuar në të cilën theksohet se ankesa në fjalë është e pabazuar për faktin se “vendosja e posterit të kandidatit të LDK-ës mbi posterin e kandidatit të PDK-së nuk është sqaruar nga kush është bërë ky veprim”. Më tej në përgjigje theksohet se LDK i ka njoftuar anëtarët dhe simpatizantët e vet me rregullat ligjore për vendosjen e posterave, prandaj LDK ka kërkuar nga kandidati për ta bërë largimin e posterit, por për shkak të afatit të shkurtër në përgjigje “nuk kemi siguruar provë, nëse është bërë

heqja e posterit. Prandaj për ne është e papranueshme një gjë e tillë, andaj konsiderojmë se ankesa është e pabazë”.

Përgjigjes në ankesë subjekti politik LDK nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se LDK i ka mbuluar posterat e PDK-se. Gjithashtu PZAP vlerëson se LDK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur edhe më parë, rrjedhimisht konsiderohet si recidivist, rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura dhe ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 433/2010 më datën 13.12.2010

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muharrem Shala**

